



1801

4211

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 3121/Prot.

Tiranë, më 13.4.2021

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj me e-mail të datës 9.4.2021

Z. DORIAN MATLIJA
QENDRA "RES PUBLICA"

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd.24, H.3, Ap.7

Email: qendra.respublica@gmail.com

I nderuar Z. Matlija

Në vijim të kërkesës suaj për informacion, dërguar në e-mail-in zyrtar të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, më datë 9.4.2021, regjistruar me tonën nr. 3121 prot., datë 12.4.2021, sqarojmë se:

Për periudhën 20.4.2020 deri në 1.4.2021, për të cilën Ju jeni i interesuar, kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit katër këshilltarë, pjesë e njësisë së shërbimit ligjor, nga të cilët dy ishin këshilltarë ligjorë dhe dy të tjerët këshilltarë ekonomikë. Lirimi i tyre nga detyra është bërë pasi, të katërt këta këshilltarë, kanë dhënë dorëheqjen për arsye personale.

Në zbatim nenit 22, të ligjit nr. 84/2016, janë zhvilluar procedurat e rekrutimit, ku kandidatët e interesuar janë vlerësuar nga komiteti *ad hoc* i ngritur për këtë qëllim dhe në bazë të nenit 22, të rregullores për veprimtarinë e KPK-së, mbledhja e komisionerëve, si organi më i lartë vendimmarës, ka miratuar përzgjedhjen dhe emërimin në detyrë të 4 këshilltarëve të rinj.

Faleminderit dhe punë të mbarë.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Edmond Verçani

